



UEFA
NATIONS
LEAGUE™



E MARTË, 27 SHATOR 2022



SHQIPËRI - ISLANDË



STADIUMI "AIR ALBANIA"
ORA 20:45



From grassroots to Heroes

for every athlete at every level

Come and discover more at

macron
STORE

TIRANA: Ring Center Tirana
Zogu i zi, Albania
T: +35 56 82 00 67 47
tirana@macronstore.com

Find the Macron Store
closest to you



macron.com



These clubs have chosen Macron





TË DASHUR MIQ!

Kombëtarja shqiptare e futbollit nisi në muajin qershor rrugëtimin e saj në Ligën e Kombeve. Një kompeticion ku zbritëm në fushën e lojës me objektivin e qartë për të qënë fitues të grupit tonë, për të bërë të mundur kalimin në Ligën A dhe sigurimin e fazës play-off për Kampionatin Europian 2024. Rruga jonë në këtë kompeticion nuk ishte ai që shpresonim, objektivi i paracaktuar nuk u arrit duke sjellë natyrshëm zhgënjim.

Jemi koshient të gjithë se futbollit njeh momentet positive por edhe ato negative, me fitoret që të bëjnë në disa momente të harrosh dhe ato që ke për të përmirësuar si dhe humbjet që të krijojnë dyshime të mëdha. Nuk ka kohë për drama. Zhgënjimet janë një mundësi shumë e mirë për tu ringritur më i fortë duke parë që ke mbrapa detyrën për të përfaqësuar denjësisht miliona shqiptarë që i kanë sytë te kjo skuadër. Sigurisht që ky është momenti për tu rinisur drejt objektivave të rinj, për të besuar akoma me shumë te kjo skuadër, te këta djem që janë pa asnjë diskutim krenaria jonë.

Mos arritja e objektivave të paracaktuar në këtë rrugëtim të Nations League sigurisht që do të analizohet në mënyrën më të kujdesshme të mundshme, për të parë gjithçka është bërë jo mirë. Ne nuk i ikim përgjegjësi dhe e dimë gjithashtu shumë mirë se nëpërmjet kësaj analize do të dijmë të nxjerrim mësimet

më të mira për të qënë gjithmmonë e më shumë konkurrues në të ardhmen ku na presin stacione të rëndësishme.

Nuk dua të fshihem dhe dua të them se jam i ndërgjegjshëm që kjo skuadër i ka cilësitë për të bërë më mirë dhe pritshmëritë për rezultatet e Kombëtares janë më të mëdha e janë rritur ndjeshëm edhe falë këtyre djemve. Ne kemi në përbërje lojtarë të talentuar që luajnë në klube të mëdha në Europë, japin shpirtin për fanellën kuqezi dhe e ndjejnë më shumë se kushdo detyrën e përfaqësimit të kësaj fanelle. Unë e di sesa shumë i vuajnë ata momentet e vështira. Jam besimplotë se duke qëndruar të bashkuar do ja dalim për tu rikthyer në nivelin që na takon.

Tani është koha që të gjithë të marrim më shumë përgjegjësi dhe të shikojmë përpara drejt objektivit të madh: EURO 2024. Nga ndeshja me Islandën, te miqësoret e muajit tetor dhe nëntor kemi mundësinë që të përmirësojmë shumëçka për të qënë gati për një rrugëtim eliminator triumfues drejt rishkrimit të historisë. Duke bërë bashkë të gjithë elementet që të çojnë drejt suksesit, skuadër, staf teknik, federatë, tifozë dhe opinion publik, si dhe duke u përkujdesur për çdo detaj, ne do ta arrijmë objektivin tonë të madh dhe do të bëjmë të lumtur të gjithë shqiptarët.

Forca Shqipëri!

Miqësisht,
Armand Duka



BILANCI I NATIONS LEAGUE

Shqipëria E FUTBOLLIT

MES OBJEKTIVAVE DHE PROCESIT TË RINOVIMIT

Kombëtarja shqiptare e futbollit po i afrohet stacionit të fundit të këtij edicioni të UEFA Nations League. Kuqezinjtë po përgatiten për duelin final me Islandën, që luhet të martën në mbrëmje në stadiumin "Air Albania" të Tiranës e që nis në ora 20:45. Një edicion i pazakontë ky i 2022-shit, që u parapri nga vendimi i UEFA-s për të pezulluar Rusinë nga komepticionet ndërkombëtare, dhe grupi ku ishte shortuar Shqipëria mbeti kështu me tre skuadra, kuqë përveç kuqezinjve bënin pjesë Izraeli dhe Islanda. Dy skuadra shumë të forta, por Shqipëria në letër ishte një kandidate për të marrë vendin e parë në grup.

Kuqezinjtë vinin në nisje të ediiconit pas dy paraqitjeve të mira në miqësoret e marsit. Fillimisht prova me Spanjën e yjeve, që fitoi vetëm në sekondat e fundit 2-1 testin e zhvilluar në Barcelonë me kuqezinjtë që bënë një ndeshje të mirë dhe treguan se mund të luajnë si të barabartë edhe me skuadrat më të mëdha të Europës. Më pas barazimi 0-0 me Gjeorgjinë në Tiranë ishte gjithashtu një ndeshje ku skuadra e drejtuar nga trajneri Edoardo Reja prodhoi futboll të bukur dhe ishte shumë pranë fitores ndaj një skuadre shumë në formë, siç është aktualisht përfaqësuesja gjeorgjiane.

Testi i parë real ishte ai i Reikjavikut, ku Shqipëria përballej me Islandën në transfertë me motivimin e duhur dhe në gjendje optimale. Mungonte Broja për shkak dëmtimi, por kuqezinjtë arritën të gjenin



golin të parët me Taulant Seferin, duke e mbyllur pjesën e parë në avantazh. Mirëpo sapo nis pjesa e dytë ndëshkohemi dhe pësojmë golin e barazimit, që vjen pas një pakujdesie të mbrojtjes. Pavarësisht përpjekjeve rezultati nuk ndryshon deri në fund dhe Shqipëria del nga kjo transfertë me 1 pikë. Vetëm pak ditë më pas presim Izraelin në shtëpi, në një atmosferë fantastike në stadiumin "Air Albania" të mbushur plot. E nisim sërish mirë dhe pas dominimit arrijmë të kalojmë në epërsi kur Broja transformon në gol penalltinë e fituar nga Ivan Balliu. Sërish në pjesën e dytë ndëshkohemi shumë shpejt pas një



gabimi dhe Izraeli nuk fal me Solomon që mposht Berishën dhe një i njëjti lojtar arrin të shënojë edhe golin e dytë duke përmbysur avantazhin fillestar të Shqipërisë. Përfundon me fitoren 2-1 të Izraelit dhe me pengun e një ndeshjeje të luajtur mirë e një humbjeje të pamerituar për kuqezinjtë. Pas pushimeve verore Kombëtarja rikthehet në Nations League me transfertën e Tel Avivit, sërish ndaj Izraelit. Trajneri Reja duhet të bëjë llogaritë me disa mungesa të rëndësishme, ashtu siç ka ndodhur shpesh në ndeshjet e fundit ku fati i keq ka përndjekur kuqezinjtë. Mungojnë Gjimshiti, Kumbulla, Bare, ndërsa Uzuni bëhet gati në momentin e fundit pas trajtimit të vazhdueshëm nga stafi mjekësor për shkak të një dëmtimi muskulator. Tekniku provon një vendosje taktike ndryshe për t'i dhënë më shumë forcë ofensivës në atë që cilësohej si ndeshja vendimtare e grupit për tanët, pasi një fitore na fuste në lojë për vendin e parë. Dhe vendi i parë i grupit, përveçse mund të na ngjiste në Ligën A na afronte edhe më shumë me play-off-in e Euro 2024. Një ndeshje e barabartë në pjesën e parë me Shqipërinë që rrezikon me Brojën i cili ka dy raste të pastra për gol, por fati nuk është me "djaloshin e artë" kuqezi. Në startin e pjesës së dytë Izraeli gjen golin e avantazhit, por trajneri Reja bën disa zëvendësime dhe Kombëtarja arrin të barazojë pak para fundit me Uzunin e sapofutur në fushë, i cili shënon një gol spektakolar. Në minutat shtesë Izraeli arrin të shfrytëzojë një moment pakujdesie duke shënuar golin e fitores me Baribo. Mbyllet 2-1 për Izraelin, ndërsa nuk ka mbaruar këtu pasi Shqipëria ka edhe ndeshjen e fundit me Islandën në shtëpi. Një sfidë që vlen shumë e që mund të na pozicionojë në vendin e dytë të grupit në rast fitoreje. Një arritje pozitive për një skuadër si e jona që u ngjiti këtë edicion në Ligën B, ku rivaliteti është shumë i lartë. Tre pikët që



do të vlenin shumë edhe për t'i dhënë motivimin e duhur skuadrës e për ti dhënë entuziazmin grupit par nisjes së eliminatorëve të Euro 2024.

Në të njëjtën kohë, tekniku Reja kishte nisur edhe një proces rinovimi duke afruar vazhdimisht në skuadër elementë të rinj, që mund të jenë baza e Kombëtares në të ardhmen. Mjafton të përmendim emra si Armando Broja, Nedim Bajrami apo Kristjan Asllani, ndërkohë që Marash Kumbulla, ndonëse i ri në moshë, mund të quhet një garanci tashmë për mbrojtjen kuqezi.

E pra, përtej rezultateve ky kompeticion i ka shërbyer Kombëtares dhe stafi teknik që të vijojë punën për rinovimin e grupit, një proces i domosdoshëm për të përgatitur bazën e të ardhmes.

Edhe disa elementë të kombëtareve të moshave duket se janë gati dhe po bëjnë nxemjen para se të tregojnë vlerat e tyre me fanellën kuqezi.

Në ekipet Kombëtare të moshave militojnë aktualisht shumë elementë cilësorë, që nga mosha U-17 e deri tek U-21 e që premtojnë një gjeneratë të shkëlqyer futbollistësh, gati për të shkruar faqe të rëndësishme në historinë e futbollit shqiptar.

Më mirë udhëtoni pa shqetësime

Asistencë
rrugore 24 orë
në gjithë
Europën.

**SIGAL UNIQA
AutoSOS**

Mbulimet që i duhen makinës tuaj për më tepër qetësi mendore gjatë udhëtimit

Shërbimet që ofrohen nga asistenca rrugore



**Qendra e
kontaktit 24/7**



**Riparim
në vend**



Karroatrec



Parkim



**Zëvendësim i
automjetit në
rast aksidenti***



**Akomodimi
në hotel***



**Riatdhesim me tren
/avion ose udhëtim
drejt mbërritjes***



Taxi

shënim

Opsionet e shënuar me *, klienti mund të përzgjedhë vetëm njërin prej këtyre shërbimeve: zëvendësim të mjetit ose akomodim në hotel ose vazhdim të udhëtimit.

 **068 606 2829**



Porosite online në:
www.shop.amacaffe.com



ama[®]
C A P S U L E

Compatible to Nespresso[®] machine

Kapsulat janë të përshtatshme për çdo aparat ekspresi Nespresso[®]

E gjeni në:

ama[®]
ARTIGIANI

eco

SPAR 

Më 6 qershor ndaj Islandës, italianin Edy Reja u ul për të 30-tën herë në stolin e Kombëtares shqiptare për të nisur rrugëtimin e ri në kompeticionin e Ligës së Kombeve.

Tekniku i njohur, i lindur në shtetin fqinj të Italisë në tetor të 1945, Edoardo Reja, ka qenë futbollist i shumë klubeve italiane dhe më pas drejtues i disa prej ekipeve më me emër në Itali dhe në Europë, teksa prej tre vitesh drejton Shqipërinë.


Karrierën si trajner e nisi 41 vite më parë, kur mori drejtimin e klubit të Molinelës, një ekipi të vogël italian, ndërsa më pas iu besuan edhe pankinat e skuadrave të tjera italiane si Atalanta, Lazio, Bologna, Torino, Genoa, Cagliari, etj.

Kulmin e karrierës së tij e pati teksa drejtoi ekipin e Napolit. Edhe pse në krye të një ekipi Kombëtar tashmë, ende Reja shihet me adhurim nga napolitanët, të cilët e admirojnë për punën e bërë në krye të klubit.

Por kush është Reja i Shqipërisë?

Pas largimit të ish-trajnerit të ekipit Kombëtar, Christian Panucci, Federata Shqiptare e Futbollit kishte në tavolinë disa emra. Ndër to ishte edhe emri i italianit Edy Reja, të cilit, Federata i besoi pa hezitim pankinën e ekipit Kombëtar.

Edy Reja, njeriu i cili e gjeti Shqipërinë në një moment të vështirë, me një skuadër që e kishte humbur identitetin e 2016, vit kur Kombëtarja arriti suksesin më të madh, duke u kualifikuar në European, arriti të rikthejë atmosferën pozitive në skuadër. Komunikues dhe fjalëpak, i qetë dhe i zhurmshëm, strikt dhe liberal, inteligjent, Reja i ktheu optimizmin ekipit tonë Kombëtar.



Tekniku italian ka arritur tre rekorde me Shqipërinë.

Fillimisht, tekniku e nisi me një humbje në Islandë me Shqipërinë që humbi minimalisht 1-0 në ndeshjen e vlefshme për eliminatoret e Europeanit, por në ndeshjen e dytë u rikthye me një fitore 2-0 ndaj Moldavisë. Po në këtë grup Kombëtarja nën drejtimin e Edy Rejës korri edhe dy fitore me goleada, 4-2 ndaj Islandës në kthim dhe 4-0 ndaj Moldavisë. Fitore me të tilla shifra Shqipëria nuk kishte arritur më parë në ndeshje zyrtare. Por më i rëndësishëm është fakti se përfaqësuesja kuqezi me italianin në krye të stolit u rrit shumë si skuadër, qoftë në aspektin e lojës, qoftë në atë të rezultateve.

Rekordi i tretë dhe më i rëndësishëm i arritur falë drejtimin të italianit Reja është Liga e Kombeve. Për herë të parë në historinë e futbollit shqiptar, Shqipëria ia doli të renditej e para e grupit 4 në Ligën C në këtë kompeticion europian.

Për çdo pyetje, Edy Reja e ka gjithmonë një përgjigje, pasi në kokën e tij, çdo veprim do të ketë një pasojë që ai e ka menduar më parë. Strategjia është pika më e fortë e tij. Tashmë tekniku kërkon të arrijë një tjetër rekord të rëndësishëm, ta rendisë Shqipërinë në krye të grupit në Ligën B, që do ta kalonte ekipin në Ligën A të Ligës së Kombeve, aty ku ndodhen më të mëdhatë e futbollit të Europës. Një skenë e rëndësishme për Shqipërinë e futbollit e që do t'i jepte një mundësi më shumë kuqezinjve për t'u kualifikuar për në finale të kampionatit European 2024.

Shumë prej shqiptarëve ishin skeptikë në fillim për italianin Reja në krye të Kombëtares, por e vërteta është se tashmë e duan të gjithë. Jo vetëm futbollistët, jo vetëm njerëzit që e njohin, por një pjesë e madhe e tifozëve shqiptarë. Me të në pankinë, Shqipëria tashmë ka ndërruar fytyrë!

Edy
REJA

ENJOY THE ZENITH EXPERIENCE



www.zenithtravel.ai



ZENITH
TRAVEL & TOURS

STAFI TEKNIK I KOMBËTARES A



EDY REJA
TRAJNER

FEDERATA
SHQIPTARE E
FUTBOLLIT



SERGIO PORRINI
ZV.TRAJNER



ERVIN BULKU
ZV.TRAJNER



HAMDİ SALIHİ
ZV.TRAJNER



ILIR BOZHIQI
TRAJNER PORTIERESH



LUIGI FEBBRARI
PERGATITES ATLETIK



LUCA LAURENTI
ZV.PERGATITES ATLETIK



ALARICO ROSSI
VIDEOANALIST



DRITAN BABAMUSTA
MANAXHER I EKITIT



GIANLUCA STESINA
DOKTOR



ILVI BEGOLLI
FIZIOTERAPIST



ARZEN VOCI
FIZIOTERAPIST



FATOS KADEMI
KIT MANAGER



#gjithmonëmeKompëtaren



unionbank.al



+355 4 238 9111



EQUAL GAME



RESPECT



VAS

GROUP

Global Travel Company

Vas Tour

DMC - EUROPE
Vienna, Austria
www.travelvas.com

Vas Tour

DMC - BOSNIA & HERZEGOVINA
Sarajevo, Bosnia & Herzegovina
www.vas.ba

Albtours D

DMC - BALKAN
Tirana, Albania
www.albtoursd.com

Vas Tour

DMC - TURKEY
Antalya, Turkey
www.vas-tour.com

Vas Tour

DMC - GCC
Dubai, UAE
www.vastour.ae

Kosovo
North Macedonia

Vas Group is composed of different businesses operating in the travel industry, each of these working to be an outstanding brand in the respective markets.

For years the company has been inspiring the travel community bringing the most distant destinations at clients reach, discovering the hidden treasures of each place, feeling the beat of ancient worlds, creating amazing memories.

Vas group is always engaged to be updated with travel innovations and coming up with several services which have widen the solutions for our business partners.


www.vasgroup.net



SHQIPËRIA



ELHAN KASTRATI



ETRIT BERISHA



GENTIAN SELMANI



FREDERIC VESELI



ENEA MIHAJ



ARLIND AJETI



ELSEID HYSAJ



ADRIAN BAJRAMI



ARDIAN ISMAJLI



ERMIR LENJANI





AMIR ABRASHI



QAZIM LAÇI



KLAUS GJASULA



KRISTJAN ASLLANI



SOKOL CIKALLESHI



ENDRI ÇEKICI



TAULANT SEFERI



ARMANDO BROJA



YLBER RAMADANI



KEIDI BARE



IVAN BALLIU



NEDIM BAJRAMI



MYRTO UZUNI



FOOTBALL ASSOCIATION OF ICELAND

Founded:	March 26, 1947
UEFA affiliation:	1957
FIFA affiliation:	1947
President:	Vanda SIGURGEIRSDÓTTIR
General secretary:	Klara BJARTMARZ
National Coach:	Arnar VIDARSSON
Address:	Knattspyrnusamband Íslands, Laugardal, IS-104, Reykjavík
Phone:	+354 510 2900
Fax:	+354 568 9793
Website:	www.ksi.is
E-mail:	ksi@ksi.is



FEDERATA SHQIPTARE E FUTBOLLIT



LISTA E ISLANDËS

EMËR	MBIEMËR	POZICIONI
Rúnar Alex	Rúnarsson	Portier
Patrik Sigurður	Gunnarsson	Portier
Elías Rafn	Ólafsson	Portier
Höskuldur	Gunnlaugsson	Mbrojtës
Davíð Kristján	Ólafsson	Mbrojtës
Guðlaugur Victor	Pálsson	Mbrojtës
Hjörtur	Hermannsson	Mbrojtës
Daníel Leó	Grétarsson	Mbrojtës
Aron Einar	Gunnarsson	Mbrojtës
Hörður Björgvin	Magnússon	Mbrojtës
Ísak Bergmann	Jóhannesson	Mesfushor
Jón Dagur	Porsteinsson	Mesfushor
Birkir	Bjarnason	Mesfushor
Arnór	Sigurðsson	Mesfushor
Aron Elís	Prándarson	Mesfushor
Stefán Teitur	Pórðarson	Mesfushor
Mikael Neville	Anderson	Mesfushor
Mikael Egill	Ellertsson	Mesfushor
Þórir Jóhann	Helgasson	Mesfushor
Hákon Arnar	Haraldsson	Mesfushor
Sveinn Aron	Gudjohnsen	Sulmues
Alfreð	Finnbogason	Sulmues
Andri Lucas	Gudjohnsen	Sulmues



FEDERATA SHQIPTARE E FUTBOLLIT



HISTORIKU

Shqipëri Islandë



Kombëtarja shqiptare e futbollit do të presë sonte për herë të parë në stadiumin kombëtar 'Air Albania' përfaqësuesen e Islandës, në sfidën e vlefshme për Ligën e Kombeve. Ky takim përkon edhe me ndeshjen e fundit të këtij rrugëtimi që nisi në muajin qershor kundër Islandës në transfertë e përfundon sot, më 27 shtator, ndaj po të njëjtit kundërshtar.

Shqipëria është përballur me Islandën në total

tetë herë, teksa kjo do të jetë sfida e nëntë mes këtyre dy përfaqësuesve. Spikat vetëm një takim miqësor më 31 mars 2004, teksa tetë ndeshjet e tjera, duke përfshirë edhe sfidën e sotme kanë qenë zyrtare. 4 prej tyre kanë qenë të vlefshme për kualifikueset e Kampionatit Europian, 2 takime kanë qenë të vlefshme për kualifikueset e Kampionatit Botëror dhe këto dy të fundit janë të vlefshme për Ligën e Kombeve.

1990

ISLANDË 2-0 SHQIPËRI



Shqipëria dhe Islanda janë takuar për herë të parë në kualifikueset e Kampionatit Europian 1992. Sfida e parë për kuqezinjtë ishte në transfertën e Islandës, më 30 maj 1990. Asokohe, në pankinën kuqezi qëndronte i ulur trajneri shqiptar Bejkush Birçe, i cili drejt Islandës udhëtonte me disa prej emrave që kanë shkruar histori në futbollin shqiptar si: Sulejman Demollari, Mirel Josa, Ylli Shehu, Foto Strakosha, Artur Lekbello, Fatbardh Jera e të tjerë. Ky takim i parë u mbyll në favor të islandezëve, të cilët triumfuan me dy gola në fund të minutave të dy fraksioneve të lojës, 42' dhe 88'.

Golat: (1-0) Arnór Gudjohnse 42'; (2-0) Atli Edvaldsson 88'

1991

SHQIPËRI 1-0 ISLANDË



Në përballjen e dytë, thuajse një vit më pas, më 26 maj 1991, mjaftoi një gol i Edmond Abazit për t'i dhënë tre pikët e arta Shqipërisë në stadiumin 'Qemal Stafa'. Nën drejtimin e po të njëjtit trajner, Bejkush Birçe, kuqezinjtë ia dolën të merrnin triumfin e parë ndaj këtij kundërshtari që i kishte mundur më parë në transfertë. Abazi realizoi golin e vetëm të sfidës në minutën e 65-të, ndërsa 12 minuta më vonë, kapiteni Sulejman Demollari e lë skuadrën me një lojtar më pak, pas ndëshkimit me karton të kuq. E megjithatë, Kombëtarja shqiptare ia doli të ruante rezultatin e të regjistronte fitoren e parë ndaj Islandës.

Golat: (1-0) Edmond Abazi 65'

2004

SHQIPËRI 2-1 ISLANDË



Pas 13 vitesh, Islanda dhe Shqipëria zbritën sërish në fushë, kësaj radhe për një miqësore. Më 31 mars 2004, dy përfaqësueset e drejtuara nga Hans Peter Briegel dhe Ásgeir Sigurvinsson u takuan në Shqipëri, në një takim që mbahet mend ende sot e kësaj dite, e që përfundoi me triumfin e kuqezinjve 2-1, me gola të Adrian Aliaj-t dhe Alban Bushi-t.

Golat: (1-0) Adrian Aliaj 42'; (1-1) Thordur Gudjonsson 66'; (2-1) Alban Bushi 75'

2012

SHQIPËRI 1-2 ISLANDË



Ndeshja e radhës mes dy kombëtareve do të ishte më 12 tetor 2012, e vlefshme për kualifikueset e Kupës së Botës 'Brazil 2014'. Në praninë e rreth 8200 tifozëve, kuqezinjtë e drejtuar nga trajneri rekordmen i Kombëtares, Gianni De Biasi u mundën me rezultatin 1-2. 'Mallkimi i minutës së fundit' na ka përmendur për një kohë të gjatë, teksa ishte prezent edhe të premtën e 12 tetorit në stadiumin 'Qemal Stafa'. Goli i vetëm për Kombëtaren u shënuar nga Edgar Çani në minutën e 29-të.

Golat: (1-0) Birkir Bjarnason 19'; (1-1) Edgar Çani 29'; (2-1) Gylfi Sigurdsson 81'

2013

ISLANDË 2-1 SHQIPËRI



Kuqezinjtë pësuan humbje edhe në ndeshjen e kthimit për kualifikueset e Kampionatit Botëror 'Brazil 2014', më 10 shtator 2013. Valdet Rama realizoi i pari dhe kaloi në avantazh Kombëtaren shqiptare, duke heshtur rreth 10 mijë të pranishmit vendas. Por islandezët përmbysnë gjithçka, fillimisht duke barazuar në pak minuta e më pas duke shënuar golin e tre pikëve në pjesën e dytë.

Golat: (0-1) Valdet Rama 9'; (1-1) Birkir Bjarnason 14'; (2-1) Kolbeinn Sigthórsson 47'

2019

ISLANDË 1-0 SHQIPËRI



Epoka "Edy Reja". Dy Kombëtareset u ritakuan sërish me njëra-tjetrën më 8 qershor 2019. Në krye të pankinës kuqezi ishte ulur tashmë trajneri Italian, Edy Reja, i cili debutoi me humbje në ndeshjen e tij të parë. Në transfertën islandeze, kuqezinjtë u mundën me rezultatin 1-0, një sfidë e vlefshme për kualifikueset e Kampionatit Europian 2020.

Golat: (1-0), Jóhann Berg Gudmundsson 22'

2019

SHQIPËRI 4-2 ISLANDË



10 shtator 2019! Një nga fitoret më të rëndësishme të shënuara nga Kombëtarja shqiptare, që zhvilloi një lojë fantastike në stadiumin 'Elbasan Arena'. Një fitore që vinte pas tre humbesh rresht ndaj Islandës sigurisht që gëzoi të madh e të vogël në këtë sfidë të vështirë, sërish e vlefshme për eliminatorët e Kampionatit Europian 2020. Një 'përzjerje' golash, nga mbrojtja në sulm, fillimisht me Kastriot Dermakun, i cili shënoi golin e avantazhit në minutën e 32-të të pjesës së parë. Në 45 minutat e dyta do të realizoheshin më pas pesë gola të tjerë, ku në radhët tona do të gjente rrjetën kundërshtarë edhe Elseid Hysaj, Odise Roshi dhe Sokol Cikalleshi.

Golat: (1-0) Kastriot Dermaku 32'; (1-1) Gylfi Sigurdsson 47'; (2-1) Elseid Hysaj 52'; (2-2) Kolbeinn Sigthórsson 58'; (3-2) Odise Roshi 79'; (4-2) Sokol Cikalleshi 83'

2021

ISLANDË 1-1 SHQIPËRI



Në dhjetor të vitit 2021, Shqipëria u shortua sërish në të njëjtin grup me Islandën në sfidat e vlefshme për Ligën e Kombeve. Pikërisht, ndaj këtij kundërshtari kuqezinjtë nisën rrugëtimin e tyre në Ligën B dhe ndaj të njëjtit rival do të mbyllim këto ndeshje të rëndësishme, ku për fat të keq, objektivi nuk u arrit. Më 6 qershor, Shqipëria barazoi për herë të parë në Islandë, ku deri në këtë datë, kuqezinjtë kishin njohur veç humbje në transfertë. Kombëtarja kishte mundësinë e artë të merrte tre pikët në këtë sfidë, pasi ishin të parët që kaluan në avantazh me Taulant Seferin, por ishullorët gjetën barazimin. Kjo është edhe sfida e fundit zyrtare mes dy përfaqësuesve, që do të ritakohen sërish sonte (27 shtator 2022) për herë të parë në 'Air Albania', në ndeshjen e vlefshme për Ligën e Kombeve.

Golat: (0-1) Taulant Seferi 30'; (1-1), Jón Dagur Thorsteinsson 49'

TIRANA

TIRANA, A CITY WITH NEVER-ENDING MOVEMENT AND ENERGY

Tirana is undoubtedly one of the liveliest and most transforming cities in Southeast Europe. It offers numerous opportunities for visitors in every season with its Mediterranean climate. A city that seemingly never sleeps, full of friendly faces and featuring surprises hidden around every corner; this is the feeling that you have walking around Tirana. Culture, adventure and active nightlife are the subject of the Albanian metropolis.

TIRANA ATTRACTIONS

Tirana is a city full of colors, attractions, churches, galleries, mosques and museums. You can start your journey from Scanderbeg's Square, in the center of the capital. Walking around this city square, you can see the Palace of Culture, the Scanderbeg's Monument, the Bank of Albania, the National Historical Museum and the symbol of the city the Clock Tower where you can enjoy a fantastic view of the city. The Clock Tower was built in 1822 by Haxhi Et'hem Beut, the same person who built the mosque next to it.

Attractions for touristic interest in the city of Tirana have tremendously grown in the past few years. Different

museums in Tirana that are also attractions for touristic interest, show the past history like the National Historical Museum, The National Archaeological Museum, Bunk'Art 1 and 2, House of Leaves, Museum of the Bank of Albania, The Bektashi Museum, The Historical Museum of Armed Forces, etc. Also House Studio Kadare, the local museum, which offers different activities for youth people and students related with literature and our famous writer Kadare.

The renovation of the New Bazaar in Tirana adds an attraction for all tourists who visit the capital city. This bazaar was built in 1931 and only grew in size and popularity. Today, it continues to be one of the biggest markets for meat, fish, fruits and vegetables and also near this bazaar you can find traditional restaurants.



NIGHTLIFE IN TIRANA

TIRANA HAS A LOT TO OFFER, THE CHOICE IS YOURS!

One of the most favorite areas is the New Bazaar located near the city center and has the function of a normal market and also a recreational center where you can try delicious food. You can always find a way to be entertained in Tirana in night club-mails or listening to live music, go to the theater, cinema, opera or ballet. The latest films and theater shows always meet the expectations of the growing demands of art lovers. The most fashionable neighborhood is undoubtedly Blloku, where you will find a great diversity of bars, amongst which you will definitely find something to entertain you. You can simply choose to drink something or dance under the rhythms of modern music. Obviously you will remain satisfied by places and people who like this city are always willing to have fun doing all the activities that are proposed.



Gjirokastra is a magical town on a hill, otherwise known as the Stone City with houses that look like they've been built on top of each other. The city of southern Albania has a unique architecture and is part of the UNESCO World Heritage Site. The hilltop castle is one of the largest in the Balkans and is thought that it was built in the 12th century. At the entrance to the castle, there is a gallery of cannons and a collection of weapons that date from antiquity to World War I and World War II. The center of the old town begins with "Bazaar's neck" (Qafa e Pazarit) and therefore has its origins within the fortress walls that identified the city of Gjirokastra and today it mainly contains tourist souvenir shops. Gjirokastra is also internationally recognized by the writings of famous author Ismail Kadare, who is also his birthplace. Kadare has described the city and the legends it carries in his books translated into several foreign languages. The most interesting attractions you can visit are the house of Skënduli and Zekate, of Ottoman architecture, the Path of the Fools (Sokaku i të Marrëve), the Cold War Tunnel, Gjirokastra Museum and the Ethnographic Museum which holds interesting art collections. The city unveils its values and precious heritage assets through crafts, traditional cuisine and unique architecture. All this features makes this city one of the most visited places for local and foreign visitors.

GJIROKASTRA




BERAT

In the city of Berat life began in the VI-V century, B.C. and later, in the 3rd century B.C., it became a castle town. Berat was officially declared a museum city in 1961, with monuments and cultural heritage, historical and artistic values masterfully realized from generation to generation. The unique architecture of this city, otherwise known as the "City of a Thousand and One Windows", set Berat as part of a UNESCO-protected world heritage site.

Berat is a city that combines history with art and adventure. Berat Castle of the 5th century is the crown of this ancient city with neighborhoods within the walls of the castle that are still inhabited.

Meanwhile Mangalem neighborhood one of the most visited in Berat creates the idea of a pyramid with two story houses which offer an impressive view.

Located inside a cathedral built in 1797 which stands at the highest point of the Berat Castle, the Onufri Museum is one of the most unique attractions of this city with a collection of icons and paintings where the red color dominates. This museum named "Onufri", after the Albanian painter of the 16th century. For any adventure enthusiast, this city offers many opportunities for hiking, rafting, especially in the Osumi Canyon where visitors are numerous.





Full of Life
**ZGJIDH FORMATIN TËND
TË PREFERUAR!**
NGA RISITË E FUNDIT TË UJIT TEPELENE



Uji i Skuadrës
Kombëtare
Shqiptare
të Futbollit



www.ujitepeleke.com



Për t'u ndjerë çdo ditë në formë





FEDERATA SHQIPTARE E FUTBOLLIT

ZYRTARËT E NDESHJES

SHQIPËRI - ISLANDË

ROLI	EMËR MBIEMËR	KOMBËSIA
Arbitër	Ricardo De Burgos Bengoechea	
Asistent i Parë	Iker De Francisco Grijalba	
Asistent i Dytë	Jon Nunez Fernandez	
Arbitër i Katërt	Pablo Gonzales Fuertes	
Delegat	Ghislaine Labbe	
Vezhgues	Alain Hamer	



Vodafone GigaNet

Rrjeti më i mirë celular dhe fiks
në Shqipëri. I vetmi i certifikuar
nga Umlaut për vitin 2022.



Celular



Internet Fiks



TV

Ti mund të përjetosh gjithçka
në një rrjet që nuk njeh limite

Together we can

